VENDIM
Nr.608, datë 21.12.1999

PËR KALIMIN E FONDEVE BUXHETORE TË ISH-MINISTRISË SË INFORMACIONIT, TË MBETUR NGA VITI 1999 NË FONDET BUXHETORE TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9, të ligjit nr.8439, datë 29.12.1998, "Për buxhetin e shtetit të vitit 1999" dhe të dekretit të Presidentit të Republikës nr.2473, datë 28.10.1999, "Për emërimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e ministrit të Shtetit pranë Kryeministrit, [Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Miratimin e kalimit të fondeve buxhetore të mbetura nga viti 1999 të ish-Ministrisë së Informacionit në fondin buxhetor të Këshillit të Ministrave.

2.Aparati i Këshillit të Ministrave të realizojë marrjen në dorëzim të inventarit të ish-Ministrisë së Informacionit dhe të shlyejë të gjitha detyrimet financiare kundrejt punonjësve të asaj ministrie dhe të tretëve, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

3.Ngarkohen aparati i Këshillit të Ministrave dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta